



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



ZYRA PËR REGJISTRIMIN, CERTIFIKIMIN DHE KONTROLLIN FINANCIAR TË SUBJEKTEVE POLITIKE (Zyra) NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE (KQZ) sipas autorizimeve të dhëna me paragrafin 1 të nenit 21 dhe në përputhje me nënparagrafin 4, paragrafi 6 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike (LFSP), me datën 11.07.2024, merr këtë:

VENDIM

Për shqiptimin e gjobës për subjektin politik PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS

- I. Subjektit politik PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS, i shqiptohet gjoba në vlerë katër mijë (4,000) euro për shkeljen sipas nënparagrafit 4, paragrafi 6 i nenit 21 të LFSP.
- II. Subjekti politik PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS, obligohet që brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të këtij vendimi, të paguaj shumën e gjobës së shqiptuar sipas pikës I të këtij vendimi dhe të dorëzojë në Zyrës një kopje të fletëpagesës së gjobës së paguar.
- III. Me kalimin e afatit të përcaktuar në pikën II të këtij vendimi, gjobat ekzekutohen në mënyrë të detyrueshme nga Përmbartuesi Privat.
- IV. Vendimet e Zyrës për shqiptimin e gjobave hyjnë në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme.

Arsyetim

Subjekti politike PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS, është subjekt politik i regjistruar sipas legjislacionit në fuqi nga data 19.07.2001.

Subjekteve politike të regjistruara u kërkohet që të kenë një adresë të selisë, të cilën e deklarojnë përmes Azhurnimeve vjetore ku kërkohet adresa e selisë së partisë.

Në përputhje me nenin 15 të LFSP ku theksohet qartë se, raporti vjetor financiar i subjektit politik të regjistruar duhet të përmbajë të dhënat për të gjitha shpenzimet si dhe regjistrin e të gjitha kontributeve për subjektin e regjistruar politik.

Subjekti politik edhe pse e ka shfrytëzuar lokalitetin për zyrë gjatë vitit 2023, nuk ka paraqitur këtë shpenzim në raportin vjetor financiar për vitin 2023, qoftë si e hyrë nga kontributi në natyrë, në mallra dhe shërbime, dhe as si shpenzim nga qiraja.

Mos pasqyrimi i shpenzimeve apo kontributeve të subjektit politik paraqet shkelje të nenit 15 të LFSP dhe si rezultat kjo shkelje gjohet në përputhje me nënparagrafin 4, paragrafi 6 i nenit 21 të LFSP.

Subjekti politik PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS, obligohet që pagesën ta kryejë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit për shqiptimin e gjobës përmes komunikimit zyrtar elektronik. Pagesa e gjobës duhet të dëshmohet përmes dorëzimit të kopjes së fletëpagesës në Zyrë.

Në rast të dështimit të pagesës së gjobës brenda afatit të dhënë si në pikën II të këtij vendimi, gjoba e shqiptuar ndaj subjektit politik do të ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Përmbaruesi Privat.

Nga sa u tha më lartë, Zyra vendos për shqiptimin e gjobës në vlerë prej katër mijë (4,000) euro, sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Prishtinë, 11.07.2024

Drejtori i Zyrës



Besnik Buzhala

Vendimi i dërgohet:

- Kryetari të subjektit politik PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS
- Përfaqësuesit të autorizuar financiar të subjektit politik PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS.

Këshilla juridike: Subjekti politik mund të inicojë padi kundër vendimit të Zyrës për shqiptimin e gjobave, pranë gjykatës kompetente të shkallës së parë, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, pas njoftimit për vendimin. Inicimi i padisë nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.